



BASHKIMI EVROPIAN

DELEGACIONI I BASHKIMIT EVROPIAN

Shkup, 19 shtator 2013

**Konferenca e Vizibilitetit për projektet IPA 2009
mbi mjedisin e tarifës së Integruar në Administratën Doganore
Hotel Kontinental, 11.00**

Fjalim
Aivo ORAV
Shef i Delegacionit të BE-së

**I nderuari drejtor Kargov,
Mysafirë të shquar,
Zonja dhe zotërinj,**

Kam nderin që jam sot këtu mes jush, për të promovuar dy projekte të ndërlidhura për ndihmë teknike, të financuara në suaza të instrumentit për para-anëtarësim, për të mbështetur Administratën Doganore. Ndihma e Bashkimit Evropian për Administratën Doganore, përfshirë këtu edhe projektin e ardhshëm të furnizimit, arrin vlerën 2.5 milionë euro.

Unioni Doganor, i cili sivjet kremtoi 45 vjetorin e vet, është një nga gurthemet e Bashkimit Evropian. Që nga krijimi i vet, Unioni Doganor është zgjeruar si në numër, prej 6 deri në 28 anëtarë, ashtu edhe për nga cilësia, duke u bërë një treg i vetëm. Lëvizja e lirë e mallërave përbrenda tregut të vetëm mund të funksionojë siç duhet vetëm nëse në kufijtë e tij të jashtëm zbatohen në mënyrë rigoroze rregullat e përbashkëta. Kjo nënkupton që autoritetet doganore të të gjitha shteteve anëtare të BE-së duhet të veprojnë sikur të ishin një.

Sot, agjencitë doganore përballen me sfida të reja: ato duhet të sigurojnë rrjedhën e qetë të tregtisë duke zbatuar kontrole të domosdoshme dhe njëkohësisht, duke mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve. Për të arritur ekuilibrin e duhur mes këtyre kërkesave, duhet të modernizohen procedurat doganore dhe metodat e kontrollit dhe duhet të përforcohet bashkëpunimi ndërmjet agjencive të ndryshme. Synimi kryesor është ruajtja e pozicionit të rëndësishëm të doganës si partner modern, të përgjegjshëm ndaj tregtisë, i cili i mbron interesat fiskale dhe të sigurisë së vendit.

Sistemet e Teknologjisë së Informimit (TI) janë duke u bërë një tipar gjithnjë e më i rëndësishëm i operacioneve doganore. Në të vërtetë, në mënyrë që ekonomia nacionale të jetë në gjendje për të konkurruar në një kontekst global, është thelbësore që sistemet TI të jenë në gjendje të shkëmbejnë informata elektronike. Sistemet e ndryshme TI që funksionojnë tani vënë bazën për të krijuar një mjedis pa letra (dokumente) për doganën dhe tregtinë, gjë që është parimi themelor i Kodit të Unionit Doganor, i cili u miratua nga Parlamenti Evropian javën e kaluar. Më lejoni të citoj deklaratën e Komisionerit Shemeta lidhur me këtë:

Unioni Doganor është historia e qetë e suksesit të BE-së. Për më se 40 vjet, ky union i ka mbrojtur qytetarët tanë, i ka ruajtur bizneset tona dhe ka lehtësuar rrjedhën gjithnjë e më të madhe të tregtisë përbrenda dhe jashtë Bashkimit Evropian. Kodi i Unionit Doganor do të garantojë që dogana të vazhdojë punën e vet vitale mirëpo në një mënyrë më efikase dhe me kosto efektive; mënyrë që përmbush më së miri sfidat e ekonomisë sonë moderne.

Kodi i Unionit Doganor do të shërbejë si korniza e re për rregullat dhe procedurat doganore. Si e tillë, kjo kornizë do të ofrojë siguri më të madhe ligjore për bizneset dhe qartësi për zyrtarët doganorë në gjithë BE-në. Kodi i ri racionalizon dhe thjeshtëson rregullat dhe procedurat doganore, dhe mundëson transaksionet më efikase doganore. Disa nga përmirësimet që janë prezantuar në Kodin e ri, janë masat për të përfunduar zhvendosjen në një mjedis pa letra – krejtësisht elektronik, si dhe dispozitat e përforcimit të procedurave më të shpejta për tregtarët e besueshëm.

Në mënyrë që ekonomia e BE-së të vazhdojë të konkurrojë në kontekst global, është jashtëzakonisht me rëndësi që sistemet doganore të Teknologjive të Informimit të jenë në gjendje të shkëmbejnë informata elektronike në bazë të standardeve dhe teknologjive të miratuara ndërkombëtare. Këto sisteme duhet të implementohen në vendet candidate, para se ato të anëtarësohen, në mënyrë që vendi të jetë i gatshëm plotësisht për të ndërvepruar me sistemet TI të shërbimeve të Komisionit dhe të Shteteve Anëtare nga data e anëtarësimit. Ndërkohë, duhet të sigurohen edhe sisteme më efikase dhe të krijohet një përmirësim i përgjithshëm në funksionimin e doganave.

Një sistem i këtillë është Mjedisi i Tarifës së Integruar, të cilin jemi duke promovuar sot. Synimi i përgjithshëm i projektit është të harmonizojë sistemin nacional doganor me sistemet përkatëse tarifore të Unionit.

Dobitë nga projektet do të ndjehen madje edhe para anëtarësimit, meqenëse operatorët nacionalë ekonomikë do të jenë në gjendje të qasin informata onlajn, të cilat do të zvogëlojnë domosdoshmërinë për të konsultuar legjislacionin dhe do të mundësojnë kalkulimin e pagesave doganore dhe do të identifikojmë dokumentet e kërkuara. Kjo do të thotë se qasja më e lehtë, më e shpejtë dhe më transparente në informata do të ketë ndikim pozitiv në punën e tyre të përditshme.

Ne jemi dëshmitarë të progresit të arritur nga Administrata Doganore gjatë viteve të fundit në disa fusha: luftimin e krimit ndërkufitar dhe tregtinë e mallërave të falsifikuara; rritja e kapaciteteve për hetim dhe shërbim të fshehtë; dhe zbatimi rigoroz i strategjisë për anti-korrupsion.

Një nga sfidat më të mëdha në të ardhmen është zbatimi i plotë i sistemeve të ndryshme TI, të hartuara në disa vitete e fundit – një proces ky të cilin e kemi mbështetur në vazhdimësi. Ne do t'i mbetemi të përkushtuar partneritetit me Administratën Doganore dhe do të vazhdojmë të mbështesim përforcimin e kapacitetit të saj, për të siguruar që ajo i plotëson prioritetet e vendosura për mbështetjen e integritit të vendit në Bashkimin Evropian.

Ju dëshiroj punë të mbarë në periudhën që vjen dhe shpresoj të takohemi përsëri këtu pas një viti për të promovuar rezultatet përfundimtare të projektit. Ju falemnderit për vëmendjen.